



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

URDHËR

Nr. 1508, Datë 26/02/2015

PËR
RREGULLAT E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT
AD HOC PËR NDJEKJEN E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT TË NDIHMËSVE
LIGJORË NË GJYKATAT ADMINISTRATIVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të paragrafit 2, të nenit 7 të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar dhe të pikës 2 të nenit 6/5 të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Krijimin e Komisionit *ad hoc* për ndjekjen e procedurave të rekrutimit të ndihmësve ligjorë në gjykatat administrative.
2. Në përbërje të Komisionit *ad hoc* janë 7 (shtatë) anëtarë, si më poshtë vijon:
 - a) kryetari i gjykatës ku janë shpallur vendet vakante;
 - b) një gjyqtar të asaj gjykate, i përzgjedhur nga trupa gjyqësore;
 - c) kancelari i asaj gjykate;
 - ç) një përfaqësues i strukturës përgjegjëse për administratën gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë;
 - d) një pedagog të së drejtës administrative në institucionet e arsimit të lartë me gradë shkencore jo më të ulët se “Doktor”;
 - dh) dy pedagogë të Shkollës së Magjistraturës.
3. Struktura përgjegjëse për administratën gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë, 7 (shtatë) ditë para fazës së vlerësimit të kandidatëve, njofton Komisionin *ad hoc* për datën e zhvillimit të kësaj faze dhe për listën e kandidatëve.



4. Komisioni *ad hoc* merr vendime në praninë e të gjithë anëtarëve të tij.
5. Për çështje procedure, vendimet merren me votim nominal.
6. Për vlerësimin e rezultateve të konkurrimit për secilin kandidat, secili prej anëtarëve jep pikët e tij. Në përfundim pikët mbledhen dhe më pas nxirret mesatarja e përgjithshme, e cila përbën edhe vlerësimin përfundimtar të kandidatit.
7. Komisioni *ad hoc* për zgjedh një apo më shumë anëtarë të tij për të kryer sekretimin e testeve të kandidatëve pjesëmarrës.
8. Struktura përgjegjëse për administratën gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë, sipas rastit, mund të caktojë pranë Komisionit *ad hoc*, një ose më shumë nëpunës të organikës së saj, për të kryer veprimtarinë e mbështetjes teknike dhe të sekretariatit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

NASIP NAÇO

